

15 janar 2026,
Prishtinë

Komisioni i Garave të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), në bazë të kompetencave të dhëna me aktet normative të FBK-së, nën suaza të mandatit që ushtron, në mbledhjen e mbajtur me datë 15.01.2026, në përbërje prej: Armend Hamiti kryetar i KG, Arianit Shala anëtar i KG dhe Ismet Ferati anëtar i KG shqyrtoi dhe miratoi këtë:

VENDIM NR.24/ 2025-26 I KOMISIONIT TË GARAVE

I. Komisioni i Garave ka shqyrtuar kërkesën e paraqitur nga klubi KBF Prishtina për regjistrimin e lojtarit Shamia Strayhorn si lojtar i huaj.

II. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe duke u mbështetur në nenin 13.16 të Propozicioneve të Garave, miratohet regjistrimi i lojtarit Shamia Strayhorn për klubin KBF Prishtina.

III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e publikimit.

ARSYETIM


Gjatë vendimmarrjes lidhur me dispozitivin e Vendimit Nr.24/2025-26, Komisioni i Garave ka marrë parasysh faktet në vijim:

- (a) Komisioni i Garave i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar nga klubi KBF Prishtina për regjistrimin e lojtares Shamia Strayhorn si lojtare e huaj.
- (b) Në bazë të nenit 13.16 të Propozicioneve të Garave të FBK-së për sezonin garues 2025/2026, Komisioni i Garave vlerëson se kërkesa në fjalë është e bazuar dhe në përputhje të plotë me aktet normative në fuqi, për rrjedhojë e miraton atë, duke lejuar regjistrimin e lojtares Shamia Strayhorn për klubin KBF Prishtina me të drejtë loje të menjëhershme.
- (c) Udhëzohet personi përgjegjës pranë FBK-së që të ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale të nevojshme për regjistrimin e lojtares Shamia Strayhorn për klubin KBF Prishtina, me të drejtë loje të menjëhershme, në përputhje me rregulloret në fuqi të FBK-së.

Komisioni i Garave:


Arianit Shala

Anëtar



Armend Hamiti

Kryetar



Ismet Ferati

Anëtar

Federata e Basketbollit të Kosovës

KËSHILLË JURIDIKE: Në pajtim me Nenin 45 të Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore, Edicioni 2025/2026, në vendimin e Komisionit të Garave është e lejuar ankesa tek Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit të FBK-së (si organ i shkallës së dytë), e cila dorëzohet më së voni 24 orë pas marrjes së vendimit. Për ankesë, paraqitësi i ankesës duhet të deponojë në llogarinë e FBK-së shumën prej 500.00 €.